



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1563/4 Prot.

Tiranë, më 11.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 40, datë 11.08.2025

“PËR MIRATIMIN E KOSTOS SË STUDIMEVE NË PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME”, QË OFROHET NGA FAKULTETI I MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, pika 3 dhe 49; në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 51; në Vendimin e KM-së nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, pika 6; në Relacionin e Grupit të Punës nr. 1563/1 prot., datë 07.08.2025 “Mbi analizën e kostos për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2025-2026”; në Vendimin Qarkullues të Rektoratit të UMT-së nr. 30, datë 07.08.2025 “Për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit “Mjekësi e përgjithshme” që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin të Mjekësisë, Tiranë”, si dhe në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 90, datë 08.08.2025, “Për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit të UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë koston e studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë sipas tabelës më poshtë:

Të dhënat e kostos	Të dhënat për Fakultetin e Mjekësisë	Të dhënat sipas peshës specifike: Dega "Mjekësi e Përgjithshme"
Pesha Specifike	100%	60.56%
Kosto direkte		
Fondi për shpenzime personeli *	747,912,900	452,915,019
Shpenzime per bursa	122,040,000	102,600,000
Total kosto direkte	869,952,900	555,515,019
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave**	74,791,290	45,291,502

Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave**	112,186,935	67,937,253
Total kosto indirekte	186,978,225	113,228,755
Total kosto (direkte + indirekte)	1,056,931,124	668,743,774
Numri i kuotave te certifikuara të studenteve MP viti akademik 25-26		2,586
Kosto për studentë (në lekë):		258,602

*Kjo vlerë ka dalë referuar PBA-së së FM, fondit të pagave të parashikuar për vitin 2026.

** Shpenzimet kapitale dhe operative janë marrë në vlerat minimale të parashikuara në VKM.

Kosto totale/student = kosto direkte + kosto indirekte
= 214,816 lekë + 43,785 lekë
= 258,602 lekë;

1. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETAR
MONIKA FIDA

ANËTARË



VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ

Konceptoi E.Tani_____